

webertec aquaseal 2K

Hidroizolues ekstremisht fleksibël me 2 komponentë

Përshkrimi

webertec aquaseal 2K është hidroizolues me 2 komponentë, me bazë çimento dhe i modifikuar me polimerë. Ka në përbërje 25kg pluhur me bazë çimento të përforcuar me aditive dhe 10kg polimerë të lëngshëm.

Avantazhet

- Për bazamente të veshtira
- Super rezistent ndaj presionit të ujit
- I përshtatshëm për pishina, tarraca, veranda, themele dhe depozita uji

Përdorimi

- webertec aquaseal 2K përdoret për hidroizolim të sipërfaqeve të mëdha dhe atyre më të vështira.
- Mbron tarracat, themelet, tanket e ujit, pishinat etj nga presioni pozitiv dhe negativ i ujit dhe lagështira.
- webertec aquaseal 2K është bazamenti i duhur për instalimin e sigurtë të pllakave në zona të ndikuara vazhdimisht nga uji, si basene ujore, pishina, shatërvane etj.

Përgatitja e bazamentit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C ,
- Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e supeve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.

Udhëzime mbi aplikimin

- Përmbajtja e thatë e thesit prej 25kg të komponentit (A) duhet të shtohet ngadalë në 10kg e komponentit të lëngshëm (B) duke e përzierë me mikser elektrik me xhiro të ulta.
- webertec aquaseal 2K aplikohet në të gjithë sipërfaqen e dëshiruar me furçë ose mallë në minimalisht 2 shtresa.
- Këndet dhe cepat duhet të mbrohen dhe izolohen me shiritat hidroizolues webertec 828. Shiritat hidroizolues duhet të vendosen midis 2 shtresave të hidroizoluesit të përgatitur.
- Aplikimi i secilës shtrese pasardhëse do të bëhet në drejtim pingul me drejtimin e shtresës paraardhëse.
- Për rezultate të kënaqshme këshillohet që shtresa hidroizoluese duhet të jetë të paktën 2mm - 3mm trashësi.
- webertec aquaseal 2K nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare, kështu që do të duhet të vishet me shtresën mbrojtëse të përshtatshme.

Veglat

Për miksim: mikser elektrik
Për rrafshim: furçë ose mallë metalike

Afati i përdorimit

12 muaj, i ruajtur në ambient të thatë, në paleta druri. Data e prodhimit, shënuar në paketim.

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuara përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k

Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq

Vore • Shqiperi

www.saint-gobain.com

NIPT : L61822023H

webertec aquaseal 2K

webertec aquaseal 2K

Hidroizolues ekstremisht fleksibël me 2 komponentë

Tabela e të dhënave teknike

Nr.Artikulli		
Lloji i paketimit	thes letre + bidon	
Sasi për njësi	25kg / thes + 10kg/bidon	
Ngjyra	Gri pluhuri / e bardhë rezina	
Kokërrzimi	0.7 mm	
Konsumi	3-3.5 kg/m2	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.
Trashësia e shtresës	2 - 3 mm në total	

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Vore • Shqiperi
www.saint-gobain.com
NIPT : L61822023H

webertec aquaseal 2K